

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2018 PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR INFRASTRUKTURËN KOMUNALE V””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për infrastrukturën komunale V”.

Qëllimi i projektit “Programi për infrastrukturën komunale V” është të kontribuojë në përmirësimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe kanalizimet në bashkitë e përfshira në program. Përcaktimi i tyre është bërë sipas prioriteteve të Masterplanit Kombëtar të Ujësjiellës-Kanalizimeve, si dhe nevojës për investime për të përmbyllur investimet e kryera në fazat e mëparshme të programit. Konkretisht, vendndodhjet Lezhë, Fier dhe Sarandë kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I dhe II të programit, ndërsa vendndodhjet Berat, Kuçovë, Gjirokastrë, Kamzë dhe Lushnjë kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme I, II, III e IV të programit.

Objektivi i programit është të kontribuojë në përmirësimin e në qëndrueshmërinë e aksesit që do të ketë popullsia e zonave të përfshira në program për ujin e pijshëm, për kanalizimet dhe pjesërisht trajtimin e ujerave të përdorura, për tarifa të pranueshme të kostove, si dhe në përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjiellës-kanalizimeve të bashkive të përfshira në program.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet financimeve të parashikuara në kuadër të projektit “Programi për infrastrukturën komunale V” synohet përmirësimi i situatës së furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujerave të përdorura në qytetet e përfshira në program, si dhe përmirësimi i treguesve të performancës për shoqëritë e ujësjiellës-kanalizimeve në bashkitë e përfshira në program.

Programi në vetvete do të implementohet në dy faza:

Faza 1 konsiston në planifikimin dhe specifikimin e investimeve nëpërmjet përditësimit dhe hartimit të studimeve të fizibilitetit. Gjithashtu, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të mbështeten institucionalisht me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e performancës për të arritur kriteret e programit të vendosura si kusht paraprak për të proceduar me hapat e zbatimit të projektit. Monitorimi i performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve do të verifikohet e do të certifikohet nga auditi i pavarur që do të kontraktohet nga financuesit e programit. Kjo fazë e programit ka filluar në fillim të vitit 2019 dhe parashikohet të zgjasë rreth 12 muaj.

Faza 2 konsiston në zbatimin në terren të investimeve të planifikuara nëpërmjet analizës së detajuar të studimeve të fizibilitetit. Shërbimet kryesore që do të kryhen gjatë kësaj faze konsistojnë në hartimin e projekteve të detajuara teknike, përgatitjen e dokumenteve të tenderimit të punimeve, si dhe kryerjen e mbikëqyrjen në terren të punimeve gjatë zbatimit të projekteve. Shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve do të marrin mbështetje institucionale të mëtijshme për të pasur operim të qëndrueshëm të investimeve, për të përmirësuar efikasitetin dhe për të lehtësuar zbatimin e planit të biznesit, planeve të operim-mirëmbajtjes, si dhe planit të ndryshimit të tarifave.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është i bazuar në Kushtetutë, në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe projektvendimi është miratuar në parim në Këshillin e Ministrave me vendimin nr.607, datë 11.9.2019.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të Bashkimit Evropian.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2018 për projektin “Programi për

infrastrukturën komunale v”, referuar protokollit të bisedimeve qeveritare të datës 22.11.2018 dhe premtimit financiar të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë (nota verbale nr.311/2017, e datës 20.12.2017).

Me anë të kësaj marrëveshjeje, të dyja qeveritë bien dakord për dhënien e mundësisë Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të marrë nga *Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW)* një kredi të butë në vlerë të përgjithshme deri në 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro, një kontribut financimi për masa të nevojshme shoqëruese deri në vlerën 3 000 000 (tre milionë) euro, për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të sipërpërmendur, si dhe një kontribut financimi në vlerë të përgjithshme deri në 6 000 000 (gjashtë milionë) euro, i cili do të përdoret për investimin.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekti që do të financohet nëpërmjet kredisë dhe granteve si më sipër është parashikuar në programin buxhetor afatmesëm 2019-2021 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe, më konkretisht, në programin “Ujësjiellës-Kanalizime”.

KËSHILLI I MINISTRAVE